



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE**

**NJOFTIM PËR MEDIA**

Ditën e hënë, më 5 shkurt 2024, në mjediset e Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) u zhvillua mbledhja e radhës së AMA-s, ku morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

<b>Armela</b>	<b>KRASNIQI</b>	<b>Kryetar</b>
<b>Desada</b>	<b>METAJ</b>	<b>Zëvendëskryetar</b>
<b>Aurela</b>	<b>BICJA</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Besian</b>	<b>ZOGAJ</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Gjergji</b>	<b>HAMITI</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Jetmir</b>	<b>HALILAJ</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Joana</b>	<b>ALLUSHI</b>	<b>Anëtar</b>

AMA, pas shqyrtimit të çështjeve të rendit të ditës vendosi:

1. Pranimin e aplikimit dhe dhënien e autorizimit të shoqërisë “One Albania” sh.a për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve sipas kërkesës së përdoruesit (VOD). **(Vendim nr.10, datë 05.02.2024)**
2. Miratimin e ndryshimeve të ndodhura në strukturën e pronësisë së shoqërisë “Thematic Information Broadcasting Operator” sh.p.k., licencuar për subjektin audioviziv privat “Tv Klaudiana”. **(Vendim nr.11, datë 05.02.2024)**
3. Rinovimin e licencës së Ambasadës Franceze në Shqipëri, për ritransmetimin e programit audio me përsëritës “RFI”. **(Vendim nr.12.datë 05.02.2024)**

\*Njohja e bordit dhe diskutime lidhur me procesin që po ndjek AMA mbi matjen e audiencës.

**AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE**

**Tiranë, më 05 shkurt 2024**